



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2433/5 prot.

Datë 15/11/2023

V E N D I M
Nr. 1163/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/11/2023, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Dea Print*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “KRISTALINA.KH” SHPK, pasi nuk kanë plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimiminë procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “Blerje Shtypshkrime”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK me NIPT: L42306022T dhe me adresë: *Zona kadastrale 3183, volum 5 faqe 176, nr i pasurise 30/13, Rinas, Krujë, Durrës.*

Operatori ekonomik “Dea Print” SHPK me NIPT: L01627024F dhe me adresë: *Ndërtesë 2-katëshe, Autostrada Tiranë – Durrës, Km.4, Kashar, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT: L52122014L dhe me adresë: *Rruga “Siri Kodra” ish-Blloku i Magazinave Tregtare, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare SH.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.07.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “Blerje Shtypshkrime”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

II.2. Në datë 04.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 25.09.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Filara” SHPK	00.00 leke	skualifikuar
2. “Inpress” SHPK	26,817,700 leke	skualifikuar
3. “DEAPRINT” SHPK	29,998,000 leke	skualifikuar
4. “Dynamix Group” SHPK	38,000,100 leke	skualifikuar
5. “KRISTALINA.KH” SHPK	39,760,100 leke	kualifikuar
6. “ALBDESIGN PSP” SHPK	40,254,870 leke	kualifikuar
7. “InfoSoft Office” SHPK	40.652.654,20 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 25.09.2023, operatori ekonomik “Dynamix Group” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“. Operatori Ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k me NIPT L42306022T me vlerë të ofertës ekonomike 38,000.100 (tridhjetë e tetë milion e njëqind) lekë pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi:

1. “Formulari Përmbledhes i Vetëdeklarimit” i paraqitur në Sistemin Eletronik të APP-së nuk është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Shtojca 8, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, konsiderohet se kriteri për dorëzimin e “Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit” parashikuar në germen a, pika 1 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” nuk plotësohet. Për më tepër duke qënë se formulari i vendosur nga Operatori Ekonomik në sistem nuk është në analogji me modelin e formularit të parashtruar në brendësi të DST-së pikat 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, nuk janë të pasqyruara dhe si të tilla konsiderohen nga KVO të paplotësuara.

2. Referuar “Specifikimeve Teknike” të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ OE nuk ka dorëzuar skedë teknike për letrën offset 60 gr shtuar si kriter sipas shtojces në system të datës 04.08.2023.

→ Modeli Mandat Pagese sipas specifikimeve teknike, duhet të jetë 105x140 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 100x140mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.

→ Modeli SP2, Regjister i Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku në DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jetë 170x200mm, jashte standarteve perfshirë edhe tolerancën 3% të percaktuar nga AK.

Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 26.09.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “KRISTALINA.KH” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 04.10.2023, është administruar ankesa me nr. 2433 prot., datë 04.10.2023, e operatorit ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2433/2, datë 05.10.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx GROUP*” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datën 12.10.2023, operatori ekonomik “*KRISTALINA.KH*” SHPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “*Dynamicx GROUP*” SHPK për arsyet e dhëna nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.9. Me shkresën nr. 1499/28 prot, datë 20.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2433/4 prot datë 23.10.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx GROUP*” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.10. Në datën 25.09.2023, operatori ekonomik “*Dea Print*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“ 2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Dea Print” sh.p.k me NIPT L0162704F dhe “Optima Communication” Sh.p.k me Nipt K71903025A me vlerë të ofertës ekonomike 29,998,000 (njëzetë e nëntë milion lekë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi:

1. Skeda teknike e paraqitur në sistemin elektronik të APP-së për të dy Operatorët Ekonomik rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe si dhe e panoterizuar, fakt që bie ndesh me Dokumentat Standarde të Tenderit ku përcaktohet se: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.”

2. Referuar “Formularit të Vetëdeklarimit” të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Dea Print” sh.p.k dhe “Optima Communication” Sh.p.k, nuk rezulton që të jenë specifikuar qartë mjetet dhe makineritë e kërkuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të kërkuar në DST, ku konkretisht është cituar se: “2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri parapërgatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate);

- makineri shtypi ne rulon;

- makineri telefonimi;

- makineri për numërorator

- makineri palosëse - makine qepëse me tel

Disponimi i makinerive të mësipërme të vërtetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontrate qiraje të noterizuar, etj. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qarte të makinerive/ pajisjeve të kërkuara. Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Sqarim:

Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.”

“2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël.

Disponimi i makinerisë së mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontrate qeraje të noterizuar, etj. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë te dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerisë/ pajisjes së kërkuara. Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.” Për sa më sipër në fazën konkrete të procedurës është e domosdoshme të ishte e mirëpërcaktuar dhe e cituara në formularin përmbledhës të deklarimit lista e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara si dhe forma ligjore e disponimit të tyre (nëse janë në pronësi apo në marrje me qera).

Mosplotësimi i formularit sipas formës së parashikuar në DST e vendos Komisionin e Vlerësimit të Ofertave në një situatë të pamundur për të gjykuar më tej disponimin e ketyre makinerive në analogji me pikën 2.3.3 të DST-së. Për më tepër referuar edhe kriterit 2.3.4 të kapacitetit teknik të DST (ku kërkohet disponimi i një makinerie dixhitale për printimin e të dhënave variable), nga verifikimi i kryer nga KVO nuk rezulton që të jetë plotësuar dhe saktësuar nga BOE disponimi në njërin nga format e kërkuara në DST të kësaj pajisjeje.

3. Referuar pikës 2.3.5 “të kapacitetit teknik” të DST-së ku parashikohet se:

“2.3.5. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 makinë tip fagon në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohen e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”. Për të përmbushur kriteret e mësipërm në fazën e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklarojë disponimin e fagonit në formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të

nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.”

Në “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së nuk rezulton të jetë saktësuar disponimi i një mjet transporti të pajisur me dokumentacionin e kërkuar sipas kriterit 2.3.5 të DST-së. Pavarësisht faktit së ndodhemi përballë një Bashkimi Operatorësh ku përqindja e pjesëmarrjes është 55% me 45%, nisur nga zerat e punimeve që janë marrë përsipër të përmbushen nga Operatori Ekonomik “Dea Print” sh.p.k., ky i fundit duhet të kishte deklaruar të paktën 1 (një) mjet transporti në disponim të tij. Në nenin 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet: 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër, Kërkesat për kualifikim: të “Dea Print” sh.p.k me NIPT L0162704F dhe “Optima Communication” Sh.p.k me Nipt K71903025A nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

4. Referuar “Specifikimeve Teknike” të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ Modeli P6/1, Deftesë pranimi, konfirmim marrje objekti ekspres të brendshem, sipas specifikimeve teknike, duhet te jete 220x100 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 220x95mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.

→ Modeli SP2, Regjistër I Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku ne DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jetë 170x200mm, jashtë standarteve perfshirë edhe tolerancën 3% të percaktuar nga AK. Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të

vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”.

II.11. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 26.09.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “*KRISTALINA.KH*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.12. Në datën 05.10.2023, është administruar ankesa me nr. 2439 prot., datë 05.10.2023, e operatorit ekonomik “*Dea Print*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “*KRISTALINA.KH*” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2439/2, datë 06.10.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Dea Print*” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “*KRISTALINA.KH*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Në datën 12.10.2023, operatori ekonomik “*KRISTALINA.KH*” SHPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “*Dea Print*” SHPK për arsyet e dhëna nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe kundërshtimin e pretendimeve të shoqërisë “*Dea Print*” SHPK për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “*KRISTALINA.KH*” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 1499/29 prot, datë 00.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2439/4 prot datë 23.10.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Dea Print*” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.16. Në datën 25.09.2023, operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik “Inpress sh.p.k.”, me NIPT L52122014L dhe me vlerë të ofertës ekonomike 26.817.700 (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind)

lekë pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi:

1. "Formulari Përmbledhes i Vetëdeklarimit" i paraqitur në Sistemin Eletronik të APP-së nuk është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit", Shtojca 8, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, konsiderohet se kriteri për dorëzimin e "Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit" parashikuar në germen a, pika 1, të "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit" nuk plotësohet. Për më tepër duke qënë se formulari i vendosur nga Operatori Ekonomik në sistem nuk është në analogji me modelin e formularit të parashtruar në brendësi të DST-së pikat 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, nuk janë të pasqyruara dhe si të tilla konsiderohen nga KVO të paplotësuara.

2. Referuar "Specifikimeve Teknike" të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ Modeli "Mandat Pajese" duhet të jetë 105x140 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 100x140mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.

• Modeli SP2, Regjistër i Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku në DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jenë 170x200mm, jashtë standarteve perfshirë dhe tolerancën 3% të përcaktuar nga AK.

Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit", rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet."

II.17. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 26.09.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë "KRISTALINA.KH" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.18. Në datën 05.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3469 dhe me nr. 2440 prot., datë 05.10.2023, e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.19. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2440/2, datë

06.10.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.20. Në datën 12.10.2023, operatori ekonomik “KRISTALINA.KH” SHPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “Inpress” SHPK për arsyet e dhëna nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.21. Në datën 12.10.2023, operatori ekonomik “Dea Print” SHPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “Inpress” SHPK për arsyet e dhëna nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit.

II.22. Me shkresën nr. 1499/30 prot, datë 20.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2440/5 prot datë 23.10.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK mbi kundërshtimin e arsyesë skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “1. “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i paraqitur në Sistemin Eletronik të APP-së nuk është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Shtojca 8, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, konsiderohet se kriteri për dorëzimin e “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit” parashikuar ne germen a, pika 1 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” nuk plotësohet. Për më tepër duke qënë se formulari i vendosur nga Operatori Ekonomik në sistem nuk është në analogji me modelin e formularit të parashtruar në brendësi të DST-së pikat 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, nuk janë të pasqyruara dhe si të tilla konsiderohen nga KVO të paplotësuara.”, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK mbi kundërshtimin e arsyesë skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “1. “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i paraqitur në Sistemin Eletronik të APP-së nuk është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Shtojca 8, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, konsiderohet se kriteri për dorëzimin e “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit” parashikuar ne germen a, pika 1, të

“Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” nuk plotësohet. Për më tepër duke qënë se formulari i vendosur nga Operatori Ekonomik në sistem nuk është në analogji më modelin e formularit të parashtruar në brendësi të DST-së pikat 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, nuk janë të pasqyruara dhe si të tilla konsiderohen nga KVO të paplotësuara.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2/1,a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;”.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
<i>Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE</i>	-----
<i>Numri NIPT/et:</i>	-----
<i>Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar</i>	-----
<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	-----
<i>E-mail:</i>	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT****Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

<p>etj.</p> <p><i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me

ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- *Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës"

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes</i>	<i>Po [] Jo []</i>

<p>certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</p>	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK dhe operatori ekonomik “Inpress” SHPK, për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2/1,a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” kanë dorëzuar dokumentacionin si më :

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
<i>Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE</i>	-----
<i>Numri NIPT/et:</i>	-----
<i>Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar</i>	----- -
<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	-----
<i>E-mail:</i>	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<i>Deklarata</i>	<i>Referencat (kur janë të zbatueshme)</i>
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i>

<p>posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p>

	<p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i> <i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i> <i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i> <i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i> <i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i> <i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i> <i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i> <i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i> <i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i> <i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i> <i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i> <i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>
<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p>Po []</p>

<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë</p>	<p>Po [] Jo []</p>

<p>bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</p> <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë</p>

07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____ Emri, Mbiemri, Firma _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit**.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një **Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.4. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratatë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfitur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit

Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës

dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepet arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.”.

III.1.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënie e pëlqimit. **Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.**

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.7. Në nenin 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për

operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Agjencia Prokurimit Publik me Vendimin nr. 08, datë 05.10.2022 *“Për Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, në pikën 3 të tij përcakton se “Në çdo set DST për mallra, punë, shërbime, ndryshohet “Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit” sipas formatit, bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve respektive, për këtë lloj procedure””*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoriteti kontraktor më datë 21.07.2023. Nga verifikimi i dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumenteve standarde për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur e thjeshtuar*, sipas vendimit nr. 08, datë 05.10.2022, me ndryshimet përkatëse, konkretisht dhe të shtojcës 8 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”*, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij. Në përmbushje të kriterit të parashikuar në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 2/1.a të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik *“Dynamix Group”* SHPK dhe operatori ekonomik *“Inpress”* SHPK në përmbushje të këtij kriteri ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik Shtojcën 8 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”*, nga verifikimi i të cilit konstatohen mospërputhje në formë, por edhe në përmbajtje me ndryshimet e bëra nga ana e Agjencisë Prokurimit Publik me vendimin nr. 08, datë 05.10.2022, të *“Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”*, konkretisht tek Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, **A Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit**, dhe **B Deklarata Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**. Risia e ndryshimit në këtë shtojcë lidhet me faktin, se nëse operatorët ekonomikë nuk bëjnë deklarime të sakta dhe/ose të plota në çdo aspekt, ata rrezikojnë që të skualifikohen ose përjashtohen jo vetëm nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, por edhe më gjerë nga fitimi i kontratave publike, nocion ky që përfshin jo vetëm procedurat e prokurimit publik por edhe procedurat e koncesioneve, lejeve minerare, dhe ankandeve. Gjithashtu, ligjvënësi në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 *“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”*, të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* ndër të tjera ka përcaktuar, se **Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm**. Pra nga sa më sipër, arrihet në përfundimin, se operatorët ekonomikë të interesuar në një procedurë prokurimi mund të përdorin një formular vetëdeklarimi të përdorur në një procedurë tjetër ose paralele prokurimi, me kusht që informacioni në përmbajtje duhet të vazhdojë të jetë i saktë dhe i vlefshëm. Në rastin konkret operatori ekonomik pjesëmarrës *“Dynamicx GROUP”* SHPK dhe operatori ekonomik pjesëmarrës *“Inpress”* SHPK kanë përdorur tjetër formular vetëdeklarimi

nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Formulari i vetëdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK dhe formulari i vetëdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, kanë ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, ndaj për faj të vetë operatorëve ekonomikë nuk arrijnë të përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7 “*Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2/1,a “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP, çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. Në rastin konkret, operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK dhe operatori ekonomik pjesmarrës “*Inpress*” SHPK nuk kanë ofertuar sipas shtojcës 8, “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 08, datë 05.10.2022 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK dhe operatori ekonomik pjesmarrës “*Inpress*” SHPK nuk plotësojnë kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” sipas kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7 “*Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2/1,a “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pjesë e dokumentave të tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon, se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “*Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*”; “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve*”, KPP gjykon, se operatori ekonomik “*Dynamix Group*” SHPK dhe operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK duhet të kishin plotësuar shtojcën 8

“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, sipas dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.10. Në rast se operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK dhe operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK do të kishin paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet, se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx GROUP*” SHPK dhe pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Inpress*” SHPK nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Dea Print*” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “2. *Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Dea Print” sh.p.k me NIPT L0162704F dhe “Optima Communication” Sh.p.k me Nipt K71903025A me vlerë të ofertës ekonomike 29,998,000 (njëzetë e nëntë milion lekë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi:*

2. *Referuar “Formularit të Vetëdeklarimit” të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Dea Print” sh.p.k dhe “Optima Communication” Sh.p.k, nuk rezulton që të jenë specifikuar qartë mjetet dhe makineritë e kërkuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të kërkuar në DST, ku konkretisht është cituar se: “2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë:*

- *makineri parapërgatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate);*
- *makineri shtypi ne rulon;*
- *makineri telefonimi;*
- *makineri për numërorator*
- *makineri palosëse - makine qepëse me tel*

Disponimi i makinerive të mësipërme të vërtetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontrate qiraje të noterizuar, etj. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e

qarte te makinerive/ pajisjeve te kërkuara. Për përmbushjen e këtij kriteri ne fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës përkatëse te DST. Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. **Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.**

“2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël.

Disponimi i makinerisë së mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontrate qeraje të noterizuar, etj. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbaje te dhëna te mjaftueshme për identifikimin e qartë te makinerisë/ pajisjes së kërkuara. Për përmbushjen e këtij kriteri ne fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse te DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.” **Për sa më sipër në fazën konkrete të procedurës është e domosdoshme të ishte e mirëpërcaktuar dhe e cituar në formularin përmbledhës te deklarimit lista e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara si dhe forma ligjore e disponimit të tyre (nëse janë në pronësi apo në marrje me qera).**

Mosplotësimi i formularit sipas formës së parashikuar në DST e vendos Komisionin e Vlerësimit të Ofertave në një situatë të pamundur për të gjykuar më tej disponimin e ketyre makinerive në analogji me pikën 2.3.3 të DST-së. Për më tepër referuar edhe kriterit 2.3.4 të kapacitetit teknik të DST (ku kërkohet disponimi i një makinerie dixhitale për printimin e të dhënave variable), nga verifikimi i kryer nga KVO nuk rezulton që të jetë plotësuar dhe saktësuar nga BOE disponimi në njërin nga format e kërkuara në DST të kësaj pajisjeje.”.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese si më poshtë vijon:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate);
- makineri shtypi ne rrulon;
- makineri telefonimi;
- makineri per numerator
- makineri palosëse

- makine qepëse me tel

Disponimi i makinerive të mesiperme të vertetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontrate qiraje të noterizuar, etj. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qarte të makinerive/pajisjeve të kerkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor në rast të lindur drejtë të verifikojë disponimin e makinerive/pajisjeve pranë vendndodhjes së makinerisë/pajisjes të deklaruar nga ofertuesi.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël.

Disponimi i makinerisë së mesiperme të vertetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontrate qiraje të noterizuar, etj.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerisë/pajisjes së kërkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor në rast të lindur drejtë të verifikojë disponimin e makinerive/pajisjeve pranë vendndodhjes së makinerisë/pajisjes të deklaruar nga ofertuesi”.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

*Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

1. *Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:*

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- c) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
- d) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

15. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

- a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*

- b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

16. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*

- e) *çmimet ;*
- f) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
- g) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- h) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

17. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

18. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.*

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për

Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i>	<u><i>Punonjës</i></u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i> <hr/> <i>Profili i punonjësve</i> <hr/> <u><i>Makineri e mjete</i></u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i> <hr/>
<i>Emri, Mbiemri</i> _____ <i>Firma</i> _____ <i>Vula</i> _____ <i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dea print” SHPK, ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK” krijuar me dokumentin “KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME”, nënshkruar më datë 21.08.2023.

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimit të shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK”, për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Bashkëpunimi e Përkohshëm datë 21.08.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK dhe operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku në nenin 4 “KUSHTET E KONTRATES”, përcaktohet ndarja e përqindjes së bashkëpunimit dhe në nenin 5 “FURNIZIMET E SHERBIMEVE/PUNEVE” përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse që do të furnizojë secili prej anëtarëve, konkretisht, citojmë:

NENI 4

KUSHTET E KONTRATES

4.1 Shoqeria “Deaprint” sh.p.k., dhe “Optima Communication” sh.p.k. do të jete bashkerisht pergjegjese per furnizimin e te gjithe produkteve si dhe per sherbimet e kerkuara ne dokumentat e ketij tenderi.

4.2 Shoqeria “Deaprint” sh.p.k merr persiper te kryeje 55% te volumit te kontrates dhe shoqeria “Optima Communication” shpk 45% te volumit te kontrates.

NENI 5

FURNIZIMET E SHERBIMEVE/PUNEVE

Elementet konkrete te punes do te jene si me poshte:

- Shoqeria “Deaprint” sh.p.k. do te jete pergjegjese per furnizimin me lende te pare dhe punëtori, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabelës së mëposhtme dhe magazinimin.
- Shoqeria “Optima Communication” shpk do te jete pergjegjese per pregatitjen per para-shtyp te skedareve digjitale, menaxhimin e proceseve teknike te makinerive te punes, menaxhimin e ecurisë së shtypshkrimeve, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabelës së mëposhtme dhe transportin e produkteve.
- Me synim finalizimin e produkteve sipas ndarjes meposhte:

Tabela me ndarje sipas operatoreve:

Shtypshkrime Shërbimi Financiar Bankar			
1		Libër arke	Deaprint
2	SP 7/A	Ditari i pagesave të urdhër pagesave postare	Deaprint

3	SP 6	Ditari i arkëtimeve të urdhër pagesave postare	Deaprint
4		Mandat pagese (3 kopje)	Optima Communication
5		Mandat arkëtimi (3 kopje)	Optima Communication
6		Rulon letër termike për fatura	Deaprint
7		Formular dërgese Eurogiro (3 kopje)	Deaprint
8		Fletë hyrje të pullave (3 kopje)	Deaprint
9		Fletë dalje të pullave (3 kopje)	Deaprint
10		Deklaratë doganore importi	Deaprint
11		Deklaratë eksporti	Deaprint
12		Deklaratë Bis Eksporti	Deaprint
13		Deklaratë Bis Importi	Deaprint
Shtypshkrime Shërbimi Postar			
1	SP 2	Regjistër i dëftesave të pranimit të objekteve postare zyrtare	Deaprint
2	P2	Listë dërgesë e objekteve të porositura (2 kopje)	Deaprint
3	P 3 Re	Listë dorëzimi i dërgesave postare, kolipostare	Deaprint
4	P 6	Lajmërim Marrje	Deaprint
5	P8	Regjistër dorëzimi i objekteve të porositura	Deaprint
6	CN 24	Formular proces-verbal për jashtë shtetit	Deaprint
7	C 5	Lajmërim marrje për objektet me destinacion jashtë shtetit (ngjyrë portokalli)	Deaprint
8	CN 08	Reklamacione për jashtë vendit	Deaprint
9	P 9	Vëzhgesa për objekte postare dhe kolipostare	Deaprint
10	P 15 e Re	Kartelë dërgimi koli e brendshme	Deaprint
11	CN 15	Etiketë kthimi për objektet jashtë vendit (e kuqe)	Deaprint
12	E 10	Etiketa E 10 (jeshile)	Deaprint
13	CN 22	Deklaratë doganore për paketa	Deaprint
14	CN 23	Deklaratë doganore për koli	Deaprint
15	CP 71	Kartë dërgimi për koli jashtë shtetit (3 kopje)	Deaprint
16		Fletë dalje për gazetat (3 kopje)	Deaprint
17	P 6/1	Dëftesë pranimi konfirmim marrje e objektit ekspres i brendshëm	Deaprint
18		Regjistër i dorëzimit të kolive të hyra nga jashtë shtetit	Deaprint
19	AV 8	Etiketa thesi EMS me percina	Deaprint
20	E 2/1	Etiketa thesi për postë brenda vendit	Deaprint
21	CN 35	Etiketa thesi ajrore ndërkombëtare percina (të kuqe)	Deaprint
22	CN 36	Etiketa thesi SAL ndërkombëtare percina	Deaprint
23	CP 83	Etiketa tokësore të verdha me percina	Deaprint

24		<i>Proces-verbal për dëmtim të objekteve të ardhura nga jashtë vendit</i>	<i>Deaprint</i>
25		<i>Etiketa adezive thesi (1*300)</i>	<i>Optima Communication</i>
26		<i>Etikete adezive per barkod objekte postare (1*1000)</i>	<i>Optima Communication</i>
27	<i>CN 23 për EMS</i>	<i>Dëftesë pranimit objekteve EMS me barkod EE----AL</i>	<i>Optima Communication</i>
28		<i>Regjistër pranimit i objekteve postare të klasifikuara “sekret shtetëror”</i>	<i>Deaprint</i>
29	<i>P 25 e RE</i>	<i>Listë dërgesa postare të klasifikuara “sekret shtetëror”</i>	<i>Deaprint</i>
30	<i>P3 e Re</i>	<i>Listëdorëzimi i pakove postare sekrete nga Qendra Tranzite për filialet e qyteteve</i>	<i>Deaprint</i>
		<i>Shtypshkrime të tjera</i>	
1		<i>Fletë udhëtimi automjeti</i>	<i>Optima Communication</i>
2		<i>Libër korespondence zyrtare (Protokoll)</i>	<i>Optima Communication</i>
3		<i>Fletë dalje për magazinën (3 kopje)</i>	<i>Optima Communication</i>
4		<i>Fletë hyrje për magazinën (3 kopje)</i>	<i>Optima Communication</i>
5		<i>Libra magazine</i>	<i>Optima Communication</i>

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK, ku në Seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë;

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
-------------------------	-------------------------

<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i></p>	<p><u><i>Punonjës</i></u> <i>Po [X] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i></p> <hr/> <p><i>Profili i punonjësve</i></p> <hr/> <p><u><i>Makineri e mjete</i></u> <i>Po [X] Jo []</i> <i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/> <p><i>Mjete/makineri pune te shumta per realizimin me sukses te prodhimit te shtypshkrimeve Sipas kriterëve te hartuara ne DST, dokumentacionet provuese te permendura me lart, jemi te gatshem tja paraqesim AK sapo te na kerkohen. Sic eshte percaktuar ne DST, ne fazen e ofertimit kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e shtojces 8.</i></p>
<p><i>Emri, Mbiemri</i> _____</p> <p><i>Firma</i> _____</p> <p><i>Vula</i> _____</p> <p><i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____</p>	

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK ku në Seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë;

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i></p>	<p><u><i>Punonjës</i></u> <i>Po [X] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i></p> <hr/> <p><i>Profili i punonjësve</i></p> <hr/> <p><u><i>Makineri e mjete</i></u> <i>Po [X] Jo []</i> <i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> - makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate); - makineri shtypi ne rrulon; - makineri telefonimi; - makineri per numerator

	<p>- makineri palosëse</p> <p>- makine qepëse me tel Shënim:</p> <p>Makineritë janë me kontratë qiraje të noterizuar, me kompanine Deaprint sh.p.k., NUIS L01627024F.</p> <p>- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël. Shënim:</p> <p>Makineria është me kontratë qiraje të noterizuar, me kompanine Univers Promotions sh.p.k., NUIS K81324039M</p>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar secili prej tyre Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilët në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në dokumentin “*KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME*”, nënshkruar më datë 21.08.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK dhe operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, në nenin 4 “*KUSHTET E KONTRATËS*”, përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse, konkretisht, citojmë: “*Shoqëria “Deaprint” sh.p.k merr përsipër të kryejë 55% të volumit të kontratës dhe shoqëria “Optima Communication” shpk 45% të volumit të kontratës.*”

Akoma më tej, referuar nenit 5 “*FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE*”, të dokumentit “*KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME*”, nënshkruar më datë 21.08.2023 rezulton, se janë përcaktuar dhe zërat konkretë të furnizimit që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, sipas preventivit të përcaktuar në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të tenderit, ndaj për këtë arsye, secili prej operatorëve ekonomikë anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të përmbushë kriterin në lidhje me makinëritë e nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkim.

Konkretisht, nisur nga arsyeja e skualifikimit, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në shtojcën 7 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” ka

kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se disponojnë makineritë si në vijim: *“makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate); makineri shtypi ne rrulon; makineri telefonimi; makineri per numerator; makineri palosëse; makine qepëse me tel dhe makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël”*, ku në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Seksioni B: *“DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”*, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për makineritë llojin konkret të makinerisë dhe sasinë që disponojnë. Pra, nisur nga kriteri i kualifikimit, secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të deklarojë se disponon makineritë e kërkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, sipas kontratës së bashkëpunimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues *“Dea Print”* SHPK dhe *“Optima Communication”* SHPK, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit prej tyre, konstatohet, se në lidhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 *“Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”* pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, operatori ekonomik *“Optima Communication”* SHPK ka deklaruar në Seksioni B: *“DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”*, se disponon të gjitha makineritë e kërkuara dhe konkretisht makineritë si në vijim: *“makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate); makineri shtypi ne rrulon; makineri telefonimi; makineri per numerator; makineri palosëse; makine qepëse me tel dhe makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël”*, ku ka deklaruar sasinë dhe llojin e makinerisë që disponon, si dhe ka deklaruar formën e disponimit të tyre, duke deklaruar se i disponon me kontratë qeraje noteriale.

Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik *“Dea Print”* SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet, se ky i fundit në lidhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 *“Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”* pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, operatori ekonomik *“Dea Print”* SHPK ka deklaruar në Seksioni B: *“DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”*, si në vijim: *“Mjete/makineri pune te shumta per realizimin me sukses te prodhimit te shtypshkrimeve Sipas kritereve te hartuara ne DST, dokumentacionet provuese te permendura me lart, jemi te gatshem tja paraqesim AK sapo te na kerkohen. Sic eshte percaktuar ne DST, ne fazen e ofertimit kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e shtojces 8.”*, duke mos deklaruar sasinë dhe llojin e makinerisë që disponon, si dhe për më tepër duke mos deklaruar as kriterin konkret kualifikues të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kriteret kualifikuese të sipërpërmendura lidhur me disponimin e makinerive të nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe nga ku bazuar në nenin 88 pika 3, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, kërkesat teknike në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të përmbushen *nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën e tij ndër të tjera pretendon, se *“Duke qënë se pajisjet e realizimit të shtypshkrimeve nuk janë pjesë e formularit të çmimit si*

zë i veçantë, BOE me gjithë të drejtën ligjore zgjedh vetë të përcaktojë se cili nga OE do ti ketë nën menaxhim këto pajisje, mjafton të plotesohet kriteri nga githë bashkimi në tërësi. Në kuptim të referencave ligjore, BOE ka zgjedhur që pajisjet të jenë nën menaxhim të kompanisë Optima Communication, dhe e ka shprehur këtë fakt në kontratën e bashkimit: Shoqëria "Optima Communication" shpk do të jetë përgjegjëse për përgatitjen per para-shtyp të skedareve digitale, menaxhimin e proceseve teknike të makinerive të punes, menaxhimin e ecurisë së shtypshkrimeve, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabllës së mëposhtme dhe transportin e produkteve."

Nisur nga pretendimet e ankimesit, gjykojmë, se vërtet deklarimi i mësipërm i ankimesit është i vërtetë, por nga ana tjetër në nenin 5 "FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE", të dokumentit "KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME", nënshkruar më datë 21.08.2023 rezulton, se anëtari i bashkimit të shoqërive dhe konkretisht operatori ekonomik "Dea Print" shpk ka marrë përsipër që të prodhojë vetë sasinë e artikujve objekt-prokurimi të përcaktuar po në këtë nen të kontratës së bashkëpunimi, duke deklaruar se: "Shoqëria "Deaprint" sh.p.k. do të jetë përgjegjëse për furnizimin me lëndë të parë dhe punëtori, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabelës së mëposhtme dhe magazinimin", pra duhet që të disponojë një pjesë të makinerive të nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi, deklarata kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit.

Akoma më tej, vlen të theksojmë, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, në ankesën e tij i referohet vetëm makinerive të deklaruar nga operatori ekonomik "Optima Communication" SHPK, si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë, por ndërkohë referuar nenit 88, pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kërkesat për kapacitetin teknik, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kështu që, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Dea Print" SHPK, konstatohet se ky i fundit nuk ka deklaruar asnjë lloj makinerie e nevojshme për realizimin e shtypshkrimeve, në përputhje me përqindjen e furnizimeve të marra përsipër, si dhe akoma më tej, nisur nga vetë deklaratimet e shprehura në nenin 5 "FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE", të dokumentit "KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME", nënshkruar më datë 21.08.2023, ky anëtar i bashkimit të shoqërive dihet të disponojë makineri në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit për prodhimin dhe furnizimin e artikujve objekt- prokurimi.

Gjithashtu, nga vetë përcaktimi në Seksioni B: "DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)" të Shtojcës 8 "FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT" pjesë e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik është përcaktuar se: "Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:", pra operatori ekonomik ankimes ka patur detyrimin që të në rastin kur deklaroi se disponon makineri të listojë të dhënat konkrete, ndërkohë që sikurse parashtruam edhe më lart në Shtojcës 8 "FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT" të plotësuar dhe të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të shoqërive dhe konkretisht operatori ekonomik "Dea Print" SHPK është deklaruar se disponon makineri, por nuk janë listuar makineritë që

disponon, duke mos përmbushur kriteret kualifikuese lidhur me disponimin e makinerive të nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi.

Sa më sipër argumentuar, pretendimi i mësipërm i ankimuesit nuk qëndron, pasi në interpretim të nenit 88 pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Komisioni gjykon, se sipas zërave që ka marrë përsipër të realizojë operatori ekonomik “Dea Print” SHPK, mungesa e deklaramit të makinerive në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell mospërmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK” në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dea Print” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “1. Skeda teknike e paraqitur në sistemin elektronik të APP-së për të dy Operatorët Ekonomik rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe si dhe e panoterizuar, fakt që bie ndesh me Dokumentat Standarde të Tenderit ku përcaktohet se: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Seksioni 4 “Procedura”, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar gjuhët në të cilat duhet të hartohet oferta dhe konkretisht si më poshtë:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

X

Gjithashtu në Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika 2/B. PËRGATITJA E OFERTAVE dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

2. Gjuha e Ofertës *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.*

III.3.2. Në Seksionin “**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit dhe konkretisht si më poshtë:

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

(Për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri **Posta Shqiptare sh.a.**
Adresa **Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë**
Tel/Fax **042 222 315/139**
E-mail ***lindita.mulaj@postashqiptare.al***
Faqja e Internetit **www.postashqiptare.al**
Personi Përgjegjës **Lindita Mulaj**

2 Lloji i procedurës së prokurimit: “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”;

3. Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-75636-07-20-2023**

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “*Blerje Shtypshkrime*”;

5. Fondi limit: **41,477,281 (dyzet e një milion e katërqind e shatatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.**

Në Eur : 410,300 (katërqind e dhjetë e mijë e treqind) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 19.07.2023 është 101.09 Lekë/Euro

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: *Afati i dorëzimit të mallit është 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.*

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: **24.08.2023, ora 10:00**

III.3.3. Në shtojcën 7 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” në seksionin “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“Shtohet si kriter:

Për të provuar Bardhësinë dhe të dhënat mbi gramaturën e letrës për prodhimin e shtypshkrimeve (jo për kartonin), operatorët ofertues duhet të paraqesin skedën teknike të letrës, lëshuar nga prodhuesi i letrës.

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dea print” SHPK, ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK” krijuar me dokumentin “KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME”, nënshkruar më datë 21.08.2023.

III.3.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK”, për plotësimin e kriterëve kualifikuese të sipërpërmendur lidhur me skedat teknike të letrës që do të përdoret për prodhimin e shtypshkrimeve ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. *Skeda_teknike_48_gr_10_vjet_jetegjatesi_me_vule*
2. *Skeda_teknike_e_kartonit_nga_prodhuesi_me_vule*
3. *Skeda_teknike_leter_kimike_nga_prodhuesi*
4. *Skeda_teknike_leter_Offset_60_gr_nga_prodhuesi_me_vule*
5. *Skeda_teknike_leter_Offset_60_gr_nga_prodhuesi_me_vule_2*

III.3.5. Në nenin 24 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”.

Në nenin 24 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”.

Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP-ja konstaton, se në përmbushje të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur skedat teknike të kërkuara për llojin e letrës që do të përdoret për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi, ku nga shqyrtimi i tyre u evidentua se janë të papërkthyer dhe noterizuar, ndërsa gjuha e përdorur në këto skeda teknike ku pasqyrohen specifikimet teknike të letrës janë në gjuhën angleze.

Në Seksioni 4 “Procedura”, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:” të dokumentave të tenderit të modifikuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe gjuha angleze dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe vetëm në rastin kur nuk janë në gjuhën angleze. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

Në kushtet kur, procedura e prokurimit objekt-ankimi është e llojit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, si dhe nisur nga përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor në Seksioni 4 “Procedura”, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:”, ku në mbështetje të përcaktimeve të nenit 24 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ka përcaktuar se ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik do të pranohen ose

në Gjuhën Shqipe ose në Gjuhën Angleze, si dhe referuar Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika 2/B. PËRGATITJA E OFERTAVE dokumentave të tenderit të modifikuara ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë ose në Gjuhën Shqipe ose në Gjuhën Angleze siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 4.7 të njoftimit të kontratës prandaj dokumentat e ofertës në Gjuhën Angleze nuk duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik ankimues “Dea Print” SHPK ka paraqitur, skadat teknike të sipërpërmendura në Gjuhën Angleze për përmbushjen e kriterit kualifikues të cituar më sipër dhe të pashoqëruara me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në përputhje me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në Gjuhën Angleze të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i jodetyrueshëm për ankimuesin, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit lidhur me gjuhën e përdorur për hartimin e ofertës.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dea Print” SHPK pranohet.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “3. Referuar pikës 2.3.5 “të kapacitetit teknik” të DST-së ku parashikohet se:

“2.3.5. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 makinë tip fugon në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”. Për të përmbushur kriteret e mësipërm në fazën e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklarojë disponimin e fugonit ne formularin përmbledhës të vetë deklaramit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetë deklaramit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.”

Në “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së nuk rezulton të jetë saktësuar disponimi i një mjet transporti të pajisur me dokumentacionin e kërkuar sipas kriterit 2.3.5 të DST-së. Pavarësisht faktit së ndodhemi përballë një Bashkimi Operatorësh ku perqindja e pjesëmarrjes është 55% me 45%, nisur

nga zerat e punimeve që janë marrë përsipër të përmbushen nga Operatori Ekonomik “Dea Print” sh.p.k., ky i fundit duhet të kishte deklaruar të paktën 1 (një) mjet transporti në disponim të tij. Në nenin 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet: 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër, Kërkesat për kualifikim: të “Dea Print” sh.p.k me NIPT L0162704F dhe “Optima Communication” Sh.p.k me Nipt K71903025A nuk përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. ”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.5 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 (një) makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/SGS”.

Per te përmbushur kriteret e mesiperm ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaroje disponimin e fagonit ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar”.

III.4.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- *Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

2. Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

19. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

20. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

21. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

22. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

23. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

e) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

f) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

24. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

25. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

i) çmimet ;

j) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

k) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

l) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

26. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

27. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose

rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës"

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit**.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një **Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për

përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.4.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dea print” SHPK, ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK” krijuar me dokumentin “KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME”, nënshkruar më datë 21.08.2023.

III.4.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimit të shoqërive “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK”, për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë Bashkëpunimi e Përkohshëm datë 21.08.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK dhe operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku në nenin 4 “KUSHTET E KONTRATES”, përcaktohet ndarja e përqindjes së bashkëpunimit dhe në nenin 5 “FURNIZIMET E SHERBIMEVE/PUNEVE” përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse që do të furnizojë secili prej anëtarëve, konkretisht, citojmë:*

NENI 4

KUSHTET E KONTRATES

4.1 Shoqëria “Deaprint” sh.p.k., dhe “Optima Communication” sh.p.k. do të jenë bashkërisht përgjegjëse për furnizimin e të gjithë produkteve si dhe për shërbimet e kërkuara në dokumentat e këtij tenderi.

4.2 Shoqëria “Deaprint” sh.p.k merr persiper të kryejë 55% të volumit të kontrates dhe shoqëria “Optima Communication” shpk 45% të volumit të kontrates.

NENI 5

FURNIZIMET E SHERBIMEVE/PUNEVE

Elementet konkrete te punes do te jene si me poshte:

- Shoqeria “Deaprint” sh.p.k. do te jete pergjegjese per furnizimin me lende te pare dhe punëtori, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabelës së mëposhtme dhe magazinimin.
- Shoqeria “Optima Communication” shpk do te jete pergjegjese per pregatitjen per para-shtyp te skedareve digjitale, menaxhimin e proceseve teknike te makinerive te punes, menaxhimin e ecurisë së shtypshkrimeve, realizimin e shtypshkrimeve sipas tabelës së mëposhtme **dhe transportin e produkteve.**
- Me synim finalizimin e produkteve sipas ndarjes meposhte:

Tabela me ndarje sipas operatoreve:

Shtypshkrime Shërbimi Financiar Bankar			
1		Libër arke	Deaprint
2	SP 7/A	Ditari i pagesave të urdhër pagesave postare	Deaprint
3	SP 6	Ditari i arkëtimeve të urdhër pagesave postare	Deaprint
4		Mandat pagese (3 kopje)	Optima Communication
5		Mandat arkëtimi (3 kopje)	Optima Communication
6		Rulon letër termike për fatura	Deaprint
7		Formular dërgese Eurogiro (3 kopje)	Deaprint
8		Fletë hyrje të pullave (3 kopje)	Deaprint
9		Fletë dalje të pullave (3 kopje)	Deaprint
10		Deklaratë doganore importi	Deaprint
11		Deklaratë eksporti	Deaprint
12		Deklaratë Bis Eksporti	Deaprint
13		Deklaratë Bis Importi	Deaprint
Shtypshkrime Shërbimi Postar			
1	SP 2	Regjistër i dëftesave të pranimit të objekteve postare zyrtare	Deaprint
2	P2	Listë dërgesë e objekteve të porositura (2 kopje)	Deaprint
3	P 3 Re	Listë dorëzimi i dërgesave postare, kolipostare	Deaprint
4	P 6	Lajmërim Marrje	Deaprint
5	P8	Regjistër dorëzimi i objekteve të porositura	Deaprint
6	CN 24	Formular proces-verbal për jashtë shtetit	Deaprint
7	C 5	Lajmërim marrje për objektet me destinacion jashtë shtetit (ngjyrë portokalli)	Deaprint
8	CN 08	Reklamacione për jashtë vendit	Deaprint
9	P 9	Vëzhgesa për objekte postare dhe kolipostare	Deaprint
10	P 15 e Re	Kartelë dërgimi koli e brendshme	Deaprint
11	CN 15	Etiketë kthimi për objektet jashtë vendit (e kuqe)	Deaprint
12	E 10	Etiketa E 10 (jeshile)	Deaprint

13	CN 22	Deklaratë doganore për paketa	Deaprint
14	CN 23	Deklaratë doganore për koli	Deaprint
15	CP 71	Kartë dërgimi për koli jashtë shtetit (3 kopje)	Deaprint
16		Fletë dalje për gazetat (3 kopje)	Deaprint
17	P 6/1	Dëftesë pranimit konfirmim marrje e objektit ekspres i brendshëm	Deaprint
18		Regjistër i dorëzimit të kolive të hyra nga jashtë shtetit	Deaprint
19	AV 8	Etiketa thesi EMS me percina	Deaprint
20	E 2/1	Etiketa thesi për postë brenda vendit	Deaprint
21	CN 35	Etiketa thesi ajrore ndërkombëtare percina (të kuqe)	Deaprint
22	CN 36	Etiketa thesi SAL ndërkombëtare percina	Deaprint
23	CP 83	Etiketa tokësore të verdha me percina	Deaprint
24		Proces-verbal për dëmtim të objekteve të ardhura nga jashtë vendit	Deaprint
25		Etiketa adezive thesi (1*300)	Optima Communication
26		Etikete adezive per barkod objekte postare (1*1000)	Optima Communication
27	CN 23 për EMS	Dëftesë pranimit objekteve EMS me barkod EE----AL	Optima Communication
28		Regjistër pranimit i objekteve postare të klasifikuara “sekret shtetëror”	Deaprint
29	P 25 e RE	Listë dërgesa postare të klasifikuara “sekret shtetëror”	Deaprint
30	P3 e Re	Listëdorëzimi i pakove postare sekrete nga Qendra Tranzite për filialet e qyteteve	Deaprint
		Shtypshkrime të tjera	
1		Fletë udhëtimi automjeti	Optima Communication
2		Libër korespondence zyrtare (Protokoll)	Optima Communication
3		Fletë dalje për magazinën (3 kopje)	Optima Communication
4		Fletë hyrje për magazinën (3 kopje)	Optima Communication
5		Libra magazine	Optima Communication

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Dea Print”SHPK, ku në Seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë;

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <p>Mjete/makineri pune te shumta per realizimin me sukses te prodhimit te shtypshkrimeve Sipas kriterëve te hartuara ne DST, dokumentacionet provuese te permendura me lart, jemi te gatshem tja paraqesim AK sapo te na kerkohen. Sic eshte percaktuar ne DST, ne fazen e ofertimit kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e shtojces 8.</p>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK ku në Seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë;

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <p>- makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar -Computer to Plate); - makineri shtypi ne rrulon; - makineri telefonimi;</p>

	<p>- makineri per numerator</p> <p>- makineri palosëse</p> <p>- makine qepëse me tel Shënim:</p> <p>Makineritë janë me kontratë qiraje të noterizuar, me kompanine Deaprint sh.p.k., NUIS L01627024F.</p> <p>- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël. Shënim:</p> <p>Makineria eshte me kontratë qiraje të noterizuar, me kompanine Univers Promotions sh.p.k., NUIS K81324039M</p> <p><u>I (një) makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) me targe AB261DL Shënim: Automjeti eshte me kontratë qiraje të noterizuar, me Sokol RROKAJ Person Fizik, NUIS L32405034Q</u></p>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

III.4.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të

ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes

dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka dorëzuar secili prej tyre Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilët në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në dokumentin “*KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME*”, nënshkruar më datë 21.08.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Dea Print” SHPK dhe operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, në nenin 4 “*KUSHTET E KONTRATËS*”, përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse, konkretisht, citojmë: “*Shoqëria “Deaprint” sh.p.k merr përsipër të kryejë 55% të volumit të kontratës dhe shoqëria “Optima Communication” shpk 45% të volumit të kontratës.*”

Akoma më tej, referuar nenit 5 “*FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE*”, të dokumentit “*KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME*”, nënshkruar më datë 21.08.2023 rezulton, se janë përcaktuar dhe zërat konkretë të furnizimit që do të realizojë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, sipas preventivit të përcaktuar në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të

tenderit, ndaj për këtë arsye, secili prej operatorëve ekonomikë anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të përmbushë kriterin në lidhje me makinëritë e nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkim.

Konkretisht, nisur nga arsyeja e skualifikimit, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në shtojcën 7 “*Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2.3.5 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se disponojnë makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ku në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Seksioni B: “*DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*”, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për llojin targën dhe mënyrën e disponimit të automjetit. **Pra, nisur nga kriteri i kualifikimit, secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të deklarojë se disponon automjetin e kërkuar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, sipas kontratës së bashkëpunimit.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Dea Print” SHPK dhe “Optima Communication” SHPK, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit prej tyre, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 “*Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2.3.5 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK ka deklaruar në Seksioni B: “*DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*”, se disponon 1 (një) automjet për transport të përzier, ku ka deklaruar llojin, targën dhe mënyrën e disponimit të këtij automjeti. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Dea Print” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet, se ky i fundit në lidhje me kërkesën për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 “*Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2.3.5 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, operatori ekonomik “Dea Print” SHPK ka deklaruar në Seksioni B: “*DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*”, si në vijim: “*Mjete/makineri pune te shumta per realizimin me sukses te prodhimit te shtypshkrimeve Sipas kriereve te hartuara ne DST, dokumentacionet provuese te permendura me lart, jemi te gatshem tja paraqesim AK sapo te na kerkohen. Sic eshte percaktuar ne DST, ne fazen e ofertimit kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e shtojces 8.*”, duke mos deklaruar llojin, targën dhe mënyrën e disponimit të këtij automjeti, si dhe për më tepër duke mos deklaruar as kriterin konkret kualifikues të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kriteret kualifikuese të sipërpërmendura lidhur me disponimin e makinerive të nevojshme për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe nga ku bazuar në nenin 88 pika 3, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, kërkesat teknike në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën e tij ndër të tjera pretendon, se “*Duke qënë se pajisjet e realizimit të shtypshkrimeve nuk janë pjesë e formularit të çmimit si*

zë i veçantë, BOE me gjithë të drejtën ligjore zgjedh vetë të përcaktojë se cili nga OE do ti ketë nën menaxhim këto pajisje, mjafton të plotesohet kriteri nga githë bashkimi në tërësi. Në kuptim të referencave ligjore, BOE ka zgjedhur që pajisjet të jenë nën menaxhim të kompanisë Optima Communication, dhe e ka shprehur këtë fakt në kontratën e bashkimit: Shoqëria "Optima Communication" shpk do të jetë përgjegjese për përgatitjen per para-shtyp të skedareve digitale, menaxhimin e proceseve teknike të makinerive të punes, menaxhimin e ecurisë së shtypshkrimeve, realizimin e shtypshkrimeve sipas tablës së mëposhtme dhe transportin e produkteve."

Nisur nga pretendimet e ankimesit, gjykojmë, se vërtet deklarimi i mësipërm i ankimesit është i vërtetë, por nga ana tjetër në nenin 5 "FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE", të dokumentit "KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME", nënshkruar më datë 21.08.2023 rezulton, se anëtari i bashkimit të shoqërive dhe konkretisht operatori ekonomik "Optima Communication" shpk ka marrë përsipër që të bëjë transportin e të gjithë sasisë së artikujve objekt-prokurimi të përcaktuar po në këtë nen të kontratës së bashkëpunimi, duke deklaruar se: "Shoqëria "Optima Communication" shpk do të jetë përgjegjese për përgatitjen per para-shtyp të skedareve digitale, menaxhimin e proceseve teknike të makinerive të punes, menaxhimin e ecurisë së shtypshkrimeve, realizimin e shtypshkrimeve sipas tablës së mëposhtme dhe transportin e produkteve", pra duhet që të disponojë 1 (një) automjet për transport të përzier të nevojshme për transportin e artikujve objekt-prokurimi, deklarata kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit.

Kështu që, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Dea Print" SHPK, konstatohet se ky i fundit nuk ka deklaruar a disponojë 1 (një) automjet për transport të përzier të nevojshme për transportin e artikujve objekt-prokurimi, në përputhje me natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuar në aktmarrëveshje, si dhe akoma më tej, nisur nga vetë deklaratimet e shprehura në nenin 5 "FURNIZIMET E SHËRBIMEVE/PUNËVE", të dokumentit "KONTRATË BASHKËPUNIMI E PËRKOHSHME", nënshkruar më datë 21.08.2023, ky anëtar i bashkimit të shoqërive nuk është e nevojshme që të disponojë 1 (një) automjet për transport të përzier të nevojshme për transportin e artikujve objekt-prokurimi, pasi në përputhje me natyrën e pjesëmarrjes në furnizim nuk ka marrë përsipër që të kryejë furnizimin e artikujve objekt-prokurimi.

Sa më sipër argumentuar, pretendimi i mësipërm i ankimesit qëndron, pasi në interpretim të nenit 88 pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, por në rastin kur është përcaktuar natyra e pjesëmarrjes në furnizim dhe kur kjo detyrë me aktmarrëveshje i është ngarkuar plotësisht vetëm njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe kur ky i fundit vërteton se i disponon kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e një detyre konkrete të marrë përsipër për të realizuar. Komisioni gjykon, se sipas natyrës së pjesëmarrjes në furnizim që ka marrë përsipër të realizojë operatori ekonomik "Dea Print" SHPK, mungesa e deklarimit të disponojë 1 (një) automjet për transport të përzier në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, nuk sjell mospërmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 "Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit" pikën 2.3.5 "Kriteret e

Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit, pas ky kriter plotësohet nga anëtari tjetër i bashkimit të shoqërive, sikurse parashtroam më lart.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dea Print SHPK & Optima Communication SHPK” në procedurën e prokurimit në këtë fazë, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dea Print” SHPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “*Dynamicx GROUP*” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “*Modeli Mandat Pagese sipas specifikimeve teknike, duhet të jetë 105x140 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 100x140mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.*

→ *Modeli SP2, Regjister i Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku në DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jetë 170x200mm, jashtë standarteve përfshirë edhe tolerancën 3% të përcaktuar nga AK.*

Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”, lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “Dea Print” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “4. Referuar “*Specifikimeve Teknike*” të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ *Modeli P6/1, Deftesë pranimi, konfirmim marrje objekti ekspres të brendshem, sipas specifikimeve teknike, duhet te jete 220x100 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 220x95mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.*

→ *Modeli SP2, Regjistër I Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku ne DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jetë 170x200mm, jashtë standarteve përfshirë edhe tolerancën 3% të përcaktuar nga AK. Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton*

që oferta e mësipërme nuk kualifikohet”, lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “Inpress” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “2. Referuar “Specifikimeve Teknike” të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ Modeli “Mandat Pagese” duhet të jetë **105x140 mm**, ndërkohë pas matjeve rezultojnë të jenë 100x140mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.

• Modeli SP2, Regjistër i Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku në DST përcaktohen përmasat **170x210 mm**, pas matjeve konkrete rezultojnë të jenë 170x200mm, jashtë standarteve përfshirë dhe tolerancën 3% të përcaktuar nga AK.

Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezultojnë që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.6 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 1, 2, 4 – Shtypshkrime Sherbimi Bankar Financiar; dhe për zërat 1, 5, 6, 10, 17, – Shtypshkrime Sherbimi Postar, të përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.”

Mostrat/modelet duhet të dorëzohen të futur në zarf jo transparent të mbyllur të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e shoqërisë, në ditën dhe orën e hapjes së tenderit përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Këto modele do të kontrollohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Mosparaqitja e këtyre modeleve në afatin e përcaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.

PËR PIKËN 2.3.6 në Sistemin Elektronik të Prokurimeve do të publikohen si dokumentacion shtesë, **pamje të skanuara**, për secilin artikull sipas shtojcës 5, të DST-së.”.

III.5.3. Nisur nga arsyet eskualifikimit të sipërpërmendura rezultojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës “Dynamix Group” SHPK, “Dea print” SHPK dhe “Inpress” SHPK kanë dorëzuar mostrat e kërkuara në kriterin kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.6 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.5.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.5.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.5.6. Në nenin 19, pika 1 “Hedhja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara” të Ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara mund të hidhen në treg dhe/ose të vihen në përdorim, nëse janë testuar sipas një procedure të përshkruar, përputhen me rregullat metrologjike dhe kanë shenjat verifikuese të përshkruara.”.

III.5.7. Në PJESA II “MATËSIT MATERIALE TË GJATËSISË” të VKM nr. 1351, datë 3.10.2008 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Vendosja në treg 5.

Matësit e gjatësisë do vendosen në treg dhe/ose do të futen në përdorim pas miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar.

5.1 Ekzaminimi i tipit të matësve të gjatësisë do të kryhet për të demonstruar konformitetin (përputhjen) e tyre me kërkesat e specifikuara më sipër.

5.2 Numri i mostrave të ekzaminuara përcaktohet nga laboratoritë e testimit, por nuk duhet të jetë më pak se dy mostra për çdo tip.

6. Verifikimi fillestar do të përmbajë:

a) inspektimin vizual të matësit të gjatësisë, për të verifikuar konformitetin e tij me karakteristikat e tipit të miratuar në përputhje me kërkesat e specifikuara më sipër;

b) kontrollin e konformitetit të tij në lidhje me GML-të e specifikuara në pikën 2. Kontrolli në përdorim

7. Matësit materialë të gjatësisë në përdorim i nënshtrohen verifikimit periodik. Në verifikimin periodik do të zbatohen GML-të e përshkruara në “Kërkesat tekniko-metrologjike”, pika 2.”.

III.5.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.9. Në rastin konkret në kriterin kualifikues të sipërpërmendur autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të dorëzojnë mostrat për artikujt me numër rendor 1, 2, 4 – Shtypshkrime Sherbimi Bankar

Financiar; dhe për zërat 1, 5, 6, 10, 17,– Shtypshkrime Sherbimi Postar të përcaktuara në Shtojcën 6 të dokumentave të tenderit, si dhe këto mostra duhet të plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara dhe të dhëna në Shtojcën 5 të këtyre dokumentave.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar se këto mostra do të kontrollohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nëse i plotësojnë specifikimet teknike të dhëna në Shtojcën 5 dhe nëse nuk i plotësojnë këto specifikime atëherë kriteri kualifikues i siipërpërmendur do të konsiderohet i papërbushur dhe rrjedhimisht edhe oferta e paraqitur nga ofertuesit do të skualifikohet.

Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresat me shkresën nr. 1499/28 prot, datë 20.10.2023, nr. 1499/29 prot, datë 00.10.2023, nr. 1499/30 prot, datë 20.10.2023, protokolluar përkatësisht me tonat me nr. 2433/4 prot datë 23.10.2023, nr. 2439/4 prot datë 23.10.2023 dhe me nr. 2440/5 prot datë 23.10.2023, nuk rezulton që të jetë dhënë informacion se si është kryer kontrolli nga e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nëse mostrat e dorëzuara nga ankimuesit i plotësojnë apo jo specifikimet teknike të dhëna në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Nga shqyrtimi i arsyeve të skualifikimit të sipërpërmendura rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomik ankimues nuk kanë përbushur specifikimet teknike lidhur me përmasat e dhëna në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara, por nga informacioni i autoritetit kontraktor nuk konstatohet që kontrolli i përmasave të mostrave të jetë bërë me pajisje të kalibruara sikurse përcaktohet në nenin 19, pika 1 të Ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1351, datë 3.10.2008 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjrisht të kontrolluara”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyet e skualifikimit të dhëna nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me pretendimin se mostrat e dorëzuara nuk plotësojnë përmasat e përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit nuk qëndron, pasi nuk konstatohet se si është kryer kontrolli i përmasave të tyre dhe për më tepër nuk konstatohet nëse kontrolli i përmasave është bërë me pajisje të kalibruara sipas legjislacionit sektorial të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamix Group” SHPK, “Dea Print” SHPK dhe “Inpress” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik “Dynamix Group” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “2. Referuar “Specifikimeve Teknike” të kerkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:

→ OE nuk ka dorëzuar skedë teknike për letrën offset 60 gr shtuar si kriter sipas shtojces në system të datës 04.08.2023.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” në seksionin “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“Shtohet si kriter:

Për të provuar Bardhësinë dhe të dhënat mbi gramaturën e letrës për prodhimin e shtypshkrimeve (jo për kartonin), operatorët ofertues duhet të paraqesin skedën teknike të letrës, lëshuar nga prodhuesi i letrës.

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dynamix Group” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikuese të sipërpërmendur lidhur me skedat teknike të letrës që do të përdoret për prodhimin e shtypshkrimeve nuk ka dorëzuar skedat teknike.

III.6.3. Neni 21 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.6.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.6.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.6.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

III.6.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik *“Dynamix Group”* SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit sepse nuk ka dorëzuar skedën teknike për artikullin letër që do të përdoret për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”, KPP gjykon se operatori ekonomik “*Dynamix Group*” SHPK duhet të kishte dorëzuar skedën teknike për artikullin letër që do të përdoret për prodhimin e artikujve objekt-prokurimi sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ku është cituar se: “ **Për të provuar Bardhësinë dhe të dhënat mbi gramaturën e letrës për prodhimin e shtypshkrimeve (jo për kartonin), operatorët ofertues duhet të paraqesin skedën teknike të letrës, lëshuar nga prodhuesi i letrës.**”.

III.6.8. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx Group*” SHPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK, për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e ankimuesit në lidhje me skualifikimin e tij qëndrojnë pjesërisht, pasi ky operator ekonomik edhe pas arsyetimit të KPP-së nuk i përmbush përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike dhe juridike edhe pas arsyetimit të KPP do të vijojë të mbetet e skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit tjetër pjesëmarrës nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin

në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, për sa kohë që vetë gjendja faktike dhe juridike e të tij do të vijojë të mbetet e skualifikuar, ndaj për rrjedhojë pretendimet e tjera të tij nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”,”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*Dynamix Group*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*Dea Print*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*Inpress*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorit ekonomik “*Dynamix Group*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
5. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorit ekonomik “*Dea Print*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
6. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorit ekonomik “*Inpress*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “*Dynamix Group*” SHPK, “*Dea Print*” SHPK dhe “*Inpress*” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri